



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 067

KEC

HAP PAS HAPI

Trajnimi për kompetencat e motrave-edukatore
që punojnë me fëmijë të moshave 0-3 vjeç

Qëllimet e Programi

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e koncepteve të përgjithshme të kompetencave të morave-edukatore
- Njohjen me elementet e zhvillimit dhe për kujdesit të fëmijëve
- Njohjen e praktikave të përshtatshme zhvillimore që kanë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Shkathtësi për të vëzhguar dhe vlerësuar fëmijët sipas potencialit të tyre zhvillimor
- Aftësi për të planifikuar punën duke ju përshtatur nevojave dhe interesave të fëmijëve dhe familjeve të tyre
- Aftësi për organizimin e mësimit të individualizuar, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko- social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë frymën demokratike në klasë
- Aftësi për organizimin e mësimit bashkëpunues që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Shkathtësi për përdorimin e pyetësorit për vlerësimin e motër-edukatores
- Shkathtësi për përdorimin e data-bazës për përpunimin e të dhënave nga pyetësori
- Aftësi për të planifikuar masa të cilat do të përmirësojnë cilësinë e punës edukative

Përmbajtja e trajnimit fillestar për klasën e parë

Parimet themelore të kompetencave të edukatorit 3-6

Shtatë fushat e kompetencave të edukatorit:

- Ndërveprimet
- Familja dhe komuniteti
- Përfshirja, diversiteti dhe vlerat e demokracisë
- Planifikimi dhe vlerësimi
- Strategjitë e mësimdhënies
- Mjedisi i të nxënësve
- Zhvillimi profesional

Çfarë i duhet një edukatori të jetë i suksesshëm, përdorimi i instrumentit vlerësues, vëzhgim praktik në klasë, bartja e informative në data-bazë, planifikimi i udhëzimeve për ngritje të cilësisë.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet motrave-edukatore të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6, drejtorëve të I.P-ve, zyrtarëve të arsimit, inspektorëve arsimor, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi për kompetencat e edukatoreve realizohet me anë të një trajnimi 4 ditorë që përfshin gjithsej 32 orë. Gjatë trajnimit dy ditë zhvillohet vëzhgimi i edukatoreve në praktikë që mundëson njohjen me instrumentin vlerësues.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnime.